

Në bazë të nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për peshkim dhe akuakulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/24), si dhe Vendimit për shpalljen e Thirrjes Publike për dhënien në shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë nga zonat e peshkimit „ Vardar - Rrjedha e poshtme”, „ Treska”, „Pçinja”, „ Bregallnica”, „ Strumica”, Mantovo”, „ Strezhevo”, Likovë”, „ Turija”, „ Vodoça”, „Ratevo”, „Konçe" dhe „ Liqeni i Dojranit" me numër 33-4154/1 të datës 26.03.2025 të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, shpallë

THIRRJE PUBLIKE 5/2025

për dhënien në shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë nga zonat e peshkimit „ Vardar - Rrjedha e poshtme”, „ Treska”, „Pçinja”, „ Bregallnica”, „ Strumica”, Mantovo”, „ Strezhevo”, „ Likovë”, „ Turija”, „ Vodoça”, „Ratevo”, „Konçe" dhe „ Liqeni i Dojranit" për organizimin e peshkimit rekreativ

I. LËNDA

Dhënia në shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë për organizimin e peshkimit rekreativ u referohet zonave rekreative të zonave të peshkimit:

1. Zona e peshkimit „ Vardar - Rrjedha e poshtme”
 - 1.1. Zona rekreative „ Vardar – i Gjevgjeli”, e cila përfshinë rrjedhën e lumit Vardar nga bashkimi i lumit të Kovanskës deri në kufirin me Republikën e Greqisë, duke përfshirë edhe lumin Kovanska dhe të gjitha degët, më të mëdha e më të vogla, të kësaj pjese të lumit Vardar dhe sipërfaqes së sipërme të rezervuarit të Paljurgit.
2. Zona e peshkimit „ Treska”
 - 2.1. Zona rekreative „ Treska – e Kërçovës", e cila përfshinë pjesën e lumit Treska nga burimi deri te ura në rrugën që shpie nga Kërçova në fshatin Pllasnicë (ura është kufi) me të gjitha degët e lumit në atë pjesë të rrjedhës së tij dhe sipërfaqen ujore të rezervuarit Oslomej.
3. Zona e peshkimit „ Pçinja”
 - 3.1. Zona rekreative „ Pçinja – e Kumanovës", e cila përfshinë rrjedhën e lumit Pçinja nga kufiri maqedonaso - serb deri në Novo Sellë, me degët e tij lumin Bistrica, lumin Dragomanska, lumin Kumanovka, lumin Petroshnica dhe lumin Luka dhe degët e tyre në të gjithë rrjedhën, lumin Lipkovka deri te bashkimi i lumit Pçinja, lumi i Kratovës, lumi Kriva me të gjitha degët, nga bashkimi t[lumit të Kratovës në Kriva Reka deri te bashkimi i lumit Kriva në lumin Pçinja.
4. Zona e peshkimit „ Bregallnica”

4.1. Zona rekreative „ Bregallnica - Shtipska", e cila përfshinë pjesën e lumit Bregallnica nga bashkimi i lumit Zletovska deri në fshatin Ubogo me të gjitha degët në këtë pjesë të rrjedhës Bregallnica përveç lumit të Zletovës.

5. Zona e peshkimit „ Strumica”

5.1. Zona rekreative „ Strumicë”, e cila përfshinë rrjedhën e lumenjve: Strumicë, Plavijë, Turija, Vodoçnica (Bela Reka, Vodoça), Trkajna, Lebnica, Radoviška Reka, lumi Oraovicka (Stara Reka), lumi Cirońska, sipërfaqja ujore e Kënetës së Monospitovës, si dhe si dhe sipërfaqet ujore të rezervuarëve: Ilovica, Drvoshka, Novoselska dhe Liqeni i Markovës me përjashtim të zonave të mbrojtura me ligj.

6. Zona e peshkimit „ Kozjak”

6.1. Zona rekreative „ Kozjak” – Liqeni Porečko" e cila përfshinë sipërfaqen ujore të rezervuarit të Kozjakut nga bashkimi i lumit Tazhevskaja në lumin Treska deri te diga, me përjashtim të gjireve të Kolomont dhe Pekolnik.

7. Zona e peshkimit „ Mantovo”

7.1. Zona rekreative „ Mantovo", e cila përfshinë të gjithë zonën e rezervuarit të Mantovës.

8. Zona e peshkimit „ Strezhevë”

8.1. Zona rekreative „ Strezhevë", e cila përfshinë të gjithë sipërfaqen e rezervuarit të Strezhevës, përveç sipërfaqes ujore të rezervuarit deri në 2000 m në rrjedhën e sipërme të digës, anash bregut në breg dhe të gjitha ujërat nga rrjedhat ujore në pellgun e rezervuarit.

9. Zona e peshkimit „ Likovë”

9.1. Zona rekreative „ Likovë", e cila përfshinë sipërfaqen ujore të rezervuarit të Likovës dhe pjesën e lumit Likovë nga derdhja e digës së rezervuarit të Gllaznjës deri në bashkimin me rezervuarin e Likovës.

10. Zona e peshkimit „ Vodoça”

10.1. Zona rekreative "Vodoça" e cila përfshin sipërfaqen ujore të rezervuarit "Vodoça".

11. Zona e peshkimit „ Turija”

11.1. Zona rekreative „ Turija" e cila përfshin sipërfaqen ujore të rezervuarit Turija.

12. Zona e peshkimit „ Ratevë”

12.1. Zona rekreative "Ratevë" e cila përfshinë të gjithë hapësirën e liqenit artificial – rezervuari i Ratevës, pjesën e lumit Bregallnica nga burimet deri në fshatin Mitrashinci me të gjitha degët, lumin Klepallska dhe lumin Zamenicka.

13. Zona e peshkimit „Konçe”

13.1. Zona rekreative „Konçe 1 dhe Konçe 3”, e cila përfshinë të gjithë sipërfaqen ujore të rezervuarëve „Konçe 1 dhe Konçe 3”.

14. Zona e peshkimit „Liqeni i Dojranit”

14.1. Zona rekreative "Liqeni i Dojranit" e cila përfshinë sipërfaqen ujore të Liqenit të Dojranit që i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç zonës së caktuar për peshkim.

II. PERIUDHA PËR TË CILËN JEPËN NË SHFRYTËZIM PESHQIT DHE ORGANIZMAT TË TJERË UJOR

Peshqit për organizimin e peshkimit rekreativ në zonat rekreative nga zonat e peshkimit „Vardar - Rrjedha e poshtme”, „Treska”, „Pçinja”, „Bregallnica”, „Strumica”, Mantovo”, „Strezhevë”, „Likovë”, „Turijska”, „Vodoça”, „Ratevo”, „Konçe” dhe „Liqeni i Dojranit” jepen në shfrytëzim për periudh prej 12 vjet.

III. KUSHTET PËR PJESEMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike për dhënien në shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë për organizimin e peshkimit rekreativ kanë persona juridikë vendas dhe të huaj të regjistruar për veprimtari peshkimi ose klauzolë të përgjithshme afariste, me filial të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për veprimtarinë e peshkimit, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe me Klasifikimin Kombëtar të veprimtarisë, si dhe personat juridik të regjistruar në përputhje me Ligjin për Shoqata dhe Fondacione, më dorëzim të ofertave.

Subjektet e huaja juridike të cilët marrin pjesë në Thirrjen publike duhet të kenë filial të regjistruar më veprimtari peshkimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Të drejtë të dorëzimit të ofertës kanë vetëm personat juridikë që kanë ngritur dokumentacioni e tenderit.

Personat juridikë të cilët marrin pjesë në Thirrjen publike në veçanti duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. të ketë të punësuar numrin e nevojshëm të personave – rojtar të peshqeve të parashikuar në bazën e peshkimit;

2. të posedojnë ose të shfrytëzojnë hapësira për kryerjen e veprimtarisë;
3. të posedojnë ose të shfrytëzojnë së paku një mjet lundrues të motorizuar dhe/ose mjet lundrues për kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe
4. të ketë pajisje teknike për kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Personat juridikë të interesuar që marrin pjesë në Thirrjen publike pranë ofertës duhet të dorëzojnë edhe dëshmi për të vërtetuar aftësinë e tyre të përfshira në dokumentacionin e tenderit për një zonë të caktuar peshkimi.

IV. VLERA FILLESTARE E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIM TË PESHQVE DHE ORGANIZMAVE TË TJERË UJORË

Vlera fillestare e tarifës për shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë për organizimin e peshkimit rekreativ nga zonat rekreative të zonave të peshkimit të „ Vardar - Rrjedha e poshtme”, „ Treska”, „Pçinja”, „ Bregallnica”, „ Strumica”, Mantovo”, „ Strezhevo” , „ Likovë”, „ Turija”, „ Vodoça”, „Ratevo”, „Konçe” dhe „ Liqeni i Dojranit” për organizimin e peshkimit rekreativ mbartë së paku 10% të tarifës së paguar për totalin e lejeve të lëshuara në nivel vjetor.

V. AFATI PËR PARAQITJE TË OFERTAVE

Afati për dorëzimin e ofertave është (30) tridhjetë ditë, duke llogaritur nga data e shpalljes së Thirrjes publike në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa afati i fundit për paraqitjen e ofertave është i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit për dhënien e peshqve për organizimin e peshkimit rekreativ në zonën e caktuar të peshkimit.

VI. ADRESA NË TË CILËN DORËZOHEN OFERTAT

Secili ofertues i interesuar ofertën e tij e dorëzonë në adresën e mëposhtme:

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË SË UJËRAVE

Rr. „ Leninova" nr. 2,

1000 Shkup

Oferta dorëzohet përmes postës ose me dorëzim në arkivin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 15:00.

VII. TARIFA PËR LËSHIMIN E DOKUMENTACIONIT TË TENDERIT

Shuma e tarifës për lëshimin e dokumentacionit të tenderit do të jetë 1.000,00 denarë.

Pagesa e tarifës duhet të bëhet në llogarinë e mëposhtme:

Emri i pranuesit:	Ministria për financa
Banka e pranuesit:	BPRMV
Llogaria e transaksionit:	100000000063095
Shuma	1.000,00 denarë
Llogaria e pagesës:	840 xxx 03161
Shifra e të hyrave dhe Programi	722313 00
Qëllimi i dërgesave	taksa administrative

Dokumentacioni i tenderit lëshohet në arkivin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave Rr. „ Leninova nr.2, Shkup”.

Të gjithë ofertuesit e interesuar për pjesëmarrje në Thirrjen publike duhet të kenë ngritur dokumentacion të tenderit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Në rastin e më shumë ofertave të dorëzuara nga i njëjti ofertues për pika të ndryshëm të Pjesës I të kësaj Thirrjeje publike, ofertuesi duhet të ketë ngaritur dokumentacion të tenderit për secilën pikë veç e veç.

Gjatë ngritjes së dokumentacionit të tenderit nga arkivi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, është e nevojshme të lihen të dhëna për emrin, selinë, numrin e telefonit të kontaktit dhe adresën e e-mail të subjektit për të cilin po ngritet dokumentacioni i tenderit.

Të gjitha shpenzimet në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës janë në përballimin e ofertuesit.

VIII. KRITERET SIPAS TË CILËVE KRYHET ZGJEDHJA E OFERTËS MË TË MIRË

Peshqit dhe organizmat të tjerë ujqorë për organizimin rekreativ të peshkimit do të jepën në shfrytëzim të ofertuesi i cili do të plotësoj kushtet e kërkuara nga Thirrja publike dhe dokumentacioni i tenderit për dhënien në shfrytëzim të peshqit dhe organizmat të tjerë ujqorë nga zona e peshkimit mbartë së paku 10% nga tarifa e paguar për totalin e lejeve të lëshuara në nivel vjetor dhe i cili do të ofrojë përqindje më të lartë si tarifë për shfrytëzim të peshqve dhe organizmave të tjerë ujqorë në aukcion elektronik.

Në rast se pas shpalljes së Thirrjes publike për ndonjë zonë të caktuar vetëm një ofertues i cili i plotëson kushtet e përcaktuara në Thirrjen Publike dhe dokumentacionin e tenderit, konsiderohet si ofertuesi më i favorshëm.

IX. EMRI DHE ADRESA E ORGANIT KOMPETENT PER VENDIMARRJE PËRMES ANKESAVE DHE AFATËT PËRFUNDIMTARE PËR PARAQITJE TË ANKESAVE

Organ kompetent për vendosje në bazë të ankesave në procedurën për ndarjen e shfrytëzimit të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë për organizimin e peshkimit rekreativ në zonat rekreative të peshkimit është Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurat Administrative dhe Procedurat e Punësimit në Shkallë të Dytë.

Ofertuesit kanë të drejtë të ankimimi në afat prej 15 ditëve nga:

afati i përcaktuar për marrjen e vendimit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për shkak të heshtjes së administratës në rast se vendimi nuk merret brenda afatit të caktuar dhe

ditën e pranimi të vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme, në lidhje me procedurën për vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertës më të favorshme,

- dita e pranimi të vendimit për anulimin e procedurës në lidhje me shkaqet e anulimit të procedurës.

Ankimuesi i cili ka humbur të deklarojë ankesë në lidhje me dispozitat e alineve 1 dhe 2 nuk ka të drejtë të ankesës në fazë të mëvonshme të procedurës për të njëjtën bazë juridike.

X. HAPJA PUBLIKE E OFERTAVE

Hapja publike e ofertave do të mbahet në hapësirat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (Rr. „Leninova” Nr.2, Shkup), ndërsa data dhe ora do të specifikohen në dokumentacionin e tenderit për çdo zonën të peshkimit.

33 – 4154/3

të datës 27.03. 2025

Shkup

**Komisioni për zbatimin e procedurës për shfrytëzimin e
peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë për zonat e
peshkimit në rajonet e peshkimit peshkimit
„ Vardar - Rrjedha e poshtme”, „ Treska”, „Pçinja”, „ Bregallnica”,
„ Strumica”, Mantovo”, „ Strezhevo” ,
„ Likovë”, „ Turija”, „ Vodoça”, „Ratevo”, „Konçe” dhe
„ Liqeni i Dojranit” për organizimin e peshkimit rekreativ**